

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

Klasa e fëmijës suaj është zgjedhur rastësisht për të marrë pjesë në Studimin Ndërkombëtar të Trendeve/Drejtimeve në Matematikë dhe Shkencë (TIMSS) 2027. TIMSS është një projekt i rëndësishëm kërkimor arsimor i sponsorizuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Arritjeve Arsimore (IEA). TIMSS, heton/shqyrton arritjet e nxënësve në matematikë dhe shkencë, po zhvillohet në 63 vende të botës, duke përfshirë **Shqipërinë**.

Shkolla e fëmijës suaj është një nga shumë të përzgjedhurat në **Shqipëri**. Drejtori dhe mbikëqyrësi i shkollës së fëmijës suaj janë plotësisht në dijeni të projektit. Pjesëmarrja e fëmijës suaj në këtë projekt nuk do të ndikojë në notën ose përparimin e tij ose të saj në shkollë, dhe rezultatet nuk do të raportohen për nxënës ose shkolla individuale. Nxënësit pjesëmarrës do të zhvillojnë testin e arritjeve në matematikë dhe shkencë TIMSS 2027 dhe do të plotësojnë një pyetësor kontekstual për nxënësin.

TIMSS është një aktivitet i rëndësishëm për të na mbajtur ne, si prindër dhe qytetarë, të informuar rreth performancës së nxënësve tanë në **Shqipëri** në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre në vende të tjera dhe për të krahasuar kurrikulën dhe praktikën e mësimdhënies në matematikë dhe shkencë. Do të jemi në gjendje të marrim informacion aktual kombëtar dhe ndërkombëtar i cili do të ndihmojë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënësve në matematikë dhe shkencë në vendin tonë.

Po ju shkruajmë këtë letër për t'ju informuar për studimin dhe për t'ju njoftuar se e vlerësojmë pjesëmarrjen e fëmijës suaj. **URL-ja pasuese** Do të gjeni Deklaratën e Mbrojtjes së të Dhënave, e cila shpjegon të dhënat e mbledhura nëpërmjet Pyetësorit të Nxënësve TIMSS 2027 dhe mënyrën se si ruhen, përpunohen dhe publikohen të dhënat. Sipas Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (RPMDDH) dhe marrëveshjes së kontrolluesve/përgjegjës të përbashkët që kemi lidhur/nënshkruar me IEA-n, ky informacion duhet t'u ofrohet pjesëmarrësve në studim ose, për fëmijët, prindërve/kujdestarëve të tyre ligjorë.

Me respekt,

Koordinatori Kombëtar i Kërkimit: Aida MYRTO
Drejtore e Përgjithshme
Qendra e Shërbimeve Arsimore
Bulevardi Zhan D'Ark nr.23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2419257
Email: aida.myрто@qsha.gov.al

DEKLARATË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PYETËSORI PËR NXËNËSIT TIMSS 2027

Informacioni i dhënë më poshtë vlen për të dhënat e TIMSS 2027.

Identiteti dhe kontaktet e përgjegjësve të të dhënave:

Koordinatori Kombëtar i Kërkimit: Aida MYRTO
Drejtor i Përgjithshëm
Qendra e Shërbimeve Arsimore
Bulevardi Zhan D'Ark nr.23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2419257
Email: aida.myрто@qsha.gov.al

dhe

Stichting IEA Secretariaat Nederland (në tekstin e mëtejshëm "IEA")
Keizersgracht 311
1016 EE Amsterdam
Holandë
Tel: +31 20 625 3625
Email: secretariat@iea.nl

Koordinatori Kombëtar i Kërkimit dhe IEA kanë lidhur/nënshkruar një marrëveshje të përbashkët si kontrollues/përgjegjës, e cila rregullon rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse në përpunimin e të dhënave personale.

Përgjegjësi për Mbrojtjen e të Dhënave

Zyrtari i Mbrojtjes së të Dhënave

Z. Arbër Hallkaj
Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Nxënësve dhe Studentëve, Drejtoria e Shërbimeve Arsimore
Qendra e Shërbimeve Arsimore
Bulevardi Zhan D'Ark nr.23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2419257
Email: arber.hallkaj@qsha.gov.al

Përgjegjësi për Mbrojtjen e të Dhënave i IEA mund të kontaktohet në: dataprotection@iea.nl

Për çfarë qëllimi mbledhen dhe përpunohen të dhënat?

Të dhënat e mbledhura gjatë Studimit Ndërkombëtar të Trendeve/Drejtimeve në Matematikë dhe Shkencë (TIMSS 2027) përdoren ekskluzivisht për qëllime kërkimore dhe shkencore. TIMSS është një projekt kërkimor arsimor i sponsorizuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Arritjeve Arsimore (IEA).

TIMSS po zbatohet në përputhje me marrëveshjen TIMSS 2023 midis Ministrisë së Arsimit dhe IEA-s. Subjekti i të Dhënave gëzon të drejtat e parashikuara në Ligjin Nr. 9887, datë

10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dhe të drejtat e parashikuara në Nenet 15–20 të GDPR-së.

Cili informacion kërkohet?

Nxënësit në klasat e përzgjedhura të TIMSS ftohen të kryejnë testimin TIMSS 2027 në mënyrë që t'i ofrojnë studimit informacion në lidhje me arritjet e nxënësve në matematikë dhe shkencë.

Nxënësve në klasat pjesëmarrëse në TIMSS u kërkohet gjithashtu të plotësojnë Pyetësin e Kontekstit të Nxënësit TIMSS 2027 në mënyrë që studimi të marrë informacion në lidhje me gjininë, moshën, muajin, vitin, vendin e lindjes së nxënësve, vendin e lindjes së prindërve/kujdestarëve të tyre (vetëm për nxënësit e klasës së 8-të), nivelin më të lartë të arsimit të prindërve/kujdestarëve (vetëm për nxënësit e klasës së 8-të), burimet në shtëpi, gjuhën/gjuhët e folura në shtëpi dhe mendimet në lidhje me mjedisin shkollor dhe mësimet e matematikës dhe shkencës.

- Pjesëmarrja në TIMSS është vullnetare: Nxënësit janë të lirë të zgjedhin nëse duan të marrin pjesë apo jo.
- Të anketuarit nuk do të jenë në disavantazh në asnjë mënyrë për shkak të mosplotësimit të pyetësit. Ata mund të anashkalojnë pyetje individuale ose të ndërpresin përgjigjen e pyetësit në çdo kohë pa asnjë pasojë.
- Kërkohet aprovimi/dakordësimi për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Me plotësimin dhe dorëzimin e pyetësit, të anketuarit konsiderohet se kanë dhënë aprovimin/dakordësimin e tyre të informuar që të dhënat e tyre të mbledhen dhe përpunohen për qëllimet e studimit TIMSS.
- Tërheqja e aprovimit/dakordësimit është e mundur/lejuar pa dhënë asnjë arsye. Të anketuarit mund të tërheqin aprovimin/dakordësimin e tyre për përpunimin e të dhënave të tyre në çdo kohë deri në fund të periudhës së administrimit të testit. Pas kësaj date, tërheqja nuk është më e mundur sepse të dhënat do të jenë anonimizuar dhe integruar në bazën e të dhënave ndërkombëtare. Subjektet e të dhënave informohen për deklaratën gjatë plotësimit të pyetësorëve nëpërmjet një lidhjeje (linku). Subjektet e të dhënave informohen gjithashtu për këtë deklaratë nëpërmjet publikimit të saj në faqen e internetit të QSHA-së.
- Tërheqja duhet të dorëzohet në institucionin e mëposhtëm:
Qendra e Shërbimeve Arsimore
Bulevardi Zhan D'Ark Nr 23, Tiranë, Shqipëri
Email: info@qsha.gov.al
Tel: +355 4 2419257
- Pas tërheqjes, të dhënat e mbledhura deri në atë datë nuk do të përpunohen më. Çdo e dhënë personale e ruajtur do të fshihet. Tërheqja e aprovimit/dakordësimit nuk do të rezultojë në ndonjë disavantazh për të anketuarin.
- Të dhënat e kontaktit për pyetje në lidhje me mbrojtjen e të dhënave:
Për pyetje ose shqetësime në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, të anketuarit mund të kontaktojnë:

Përgjegjësi për Mbrojtjen e të Dhënave– Qendra e Shërbimeve Arsimore

Z. Arbër Hallkaj
Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Nxënësve dhe Studentëve, Drejtoria e Shërbimeve
Arsimore
Qendra e Shërbimeve Arsimore
Bulevardi Zhan D'Ark nr.23, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2419257
Email: arber.hallkaj@qsha.gov.al

Çfarë lloj të dhënash mblidhen?

Të dhënat nga përgjigjet e pyetjeve nga një nxënës që merr pjesë në TIMSS 2027 mblidhen dhe ruhen.

Kjo është në formën e numrave që përfaqësojnë përzgjedhjet (për shembull, një pyetje me zgjedhje të shumëta) ose vlerave (për shembull, një shifër për numrin e nxënësve në klasën e synuar). Të dhënat ruhen elektronikisht në formatin e të dhënave të papërpunuara. Për më tepër, TIMSS 2027 mbledh të dhëna të arritjeve nga nxënësit pjesëmarrës në formën e numrave që përfaqësojnë përzgjedhjet (për shembull, një pyetje me zgjedhje të shumëta) ose tekstit (për shembull, një përgjigje e drejtpërdrejtë për një pyetje ose vizatime për një pyetje). Ky informacion transformohet gjithashtu në të dhëna të shënuara të ruajtura elektronikisht, d.m.th., ekuivalentin e tyre numerik.

Të dhënat e arritjeve ruhen nga RM dhe IEA.

Meqenëse pyetësorët e kontekstit të nxënësve të TIMSS 2027 administrohen elektronikisht, ruhen informacione në lidhje me kohën e hyrjes dhe informacionin e pajisjes (për çdo hyrje), përgjigjet dhe historikun e përgjigjeve për secilën pyetje, duke përfshirë afatet kohore dhe nëse pyetësi është dorëzuar apo jo. Përveç kësaj, regjistrohen të dhënat e mëposhtme të regjistrimit: të gjitha ngjarjet e navigimit; çdo klikim në kutinë e kontrollit/butonin radios; çdo përzgjedhje në një menu zbritëse; fokusi (vendosja e kursorit në kuti) dhe turbullimi (vendosja e kursorit jashtë kutisë).

Ndërsa vendi/sistemi arsimor zbaton testimin TIMSS 2027 në mënyrë elektronike (duke përdorur StudyExpert dhe RM Assessment Master të IEA-s), softueri mbledh dhe ruan lloje të ndryshme të të dhënave në varësi të mënyrës se si nxënësit ndërveprojnë me të.

Mbledhen tre lloje të përgjithshme të dhënash: Të dhëna të papërpunuara të përgjigjes (1), të dhëna të ngjarjeve që lidhen me procesin (2) dhe të dhëna të sistemit (3).

Të dhënat e papërpunuara të përgjigjes (1) mblidhen dhe ruhen gjatë mbledhjes së të dhënave. Në një hap pasues të përpunimit të të dhënave, ato konvertohen në ekuivalentin e tyre numerik, të dhënat e shënuara.

Përveç të dhënave të përgjigjes, gjatë procesit të testimit mblidhen ngjarje të lidhura (2) dhe të dhënat e sistemit (3) me afatet kohore përkatëse.

Ruajtja e të dhënave të ngjarjeve që lidhen me procesin (2) përfshin ruajtjen e detajeve të hyrjes, dmth., kohën e hyrjes, daljes ose përfundimit të kohës për pjesët e testimit, ngjarjet e navigimit dhe përdorimin e mjeteve.

Të dhënat e ngjarjeve (2) regjistrohen së bashku me të dhënat e papërpunuara të përgjigjes (1) dhe pas konvertimit, të dhënat e ngjarjeve dhe të regjistrimit janë pjesë e grupit të të dhënave që i lejon IEA-së të analizojë mënyrën se si nxënësit bashkëveprojnë me testimin.

Moduli kryesor i testimit vazhdon të mbledhë të dhënat e sistemit (3), d.m.th., versionin e shfletuesit. Këto ruhen në mënyrë që IEA të mund të kontrollojë nëse vlerësimi është kryer në kushte të përshtatshme shikimi.

Informacioni i mbledhur nga pjesëmarrësit nuk mund të përdoret, në vetvete, për të identifikuar të anketuar individualë me emër. Megjithatë, një sistem ndërkombëtar identifikimi përdoret për të identifikuar në mënyrë unike çdo të anketuar (drejtorë shkollash, mësues, prindër, nxënës). Emrat e të anketuarve mund të mblidhen nga Koordinatori Kombëtar i Kërkimit, nëse lejohet brenda vendit/sistemit arsimor. Megjithatë, emrat e të anketuarve nuk duhet të ndahen me IEA-në ose ndonjë palë të tretë. IEA i siguron KKK-së softuer dhe të gjithë informacionin e nevojshëm duke i mundësuar KKK-së të paraqesë të dhëna të koduara. Kështu, të gjitha të dhënat e paraqitura duhet të jenë të koduara, domethënë: të përpunuara në një mënyrë të tillë që të dhënat personale të mos mund t'i atribuohen/referohen më një subjekti specifik të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë (çdo informacion i tillë shtesë ruhet veçmas dhe i nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të siguruar që të dhënat personale të mos i atribuohen/referohen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm).

Ku, si dhe për sa kohë ruhen të dhënat nga TIMSS?

Të dhënat e TIMSS 2027 ruhen në mënyrë të sigurt në një formë anonime, domethënë përpunohen në një mënyrë të tillë që të dhënat personale nuk mund t'i atribuohen /referohen më një subjekti specifik të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë (çdo informacion i tillë shtesë ruhet veçmas dhe i nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të siguruar që të dhënat personale nuk i atribuohen/referohen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm). Këto të dhëna nuk mund të aksesohen nga asnjë person ose sistem i jashtëm. Për më tepër, çdo punonjës i IEA-s që ka akses në të dhënat për përpunim është informuar në mënyrë të përshtatshme mbi atë që përbën një trajtim të pranueshëm të të dhënave dhe ka nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti.

Të dhënat ruhen si më poshtë:

Të dhënat e përgjigjeve ruhen për një kohë të pacaktuar në mënyrë që të mbeten të disponueshme për analiza. Këto përgjigje përfundimisht rezultojnë në një bazë të dhënash që u lejon studiuesve të krahasojnë sistemet arsimore në mbarë botën (shih aksesin publik/aksesueshmëria publike më poshtë).

1) Për Testin në Terren, të dhënat e arritjeve të nxënësve (RM Education Limited) mblidhen dhe ruhen (duke përfshirë kopjet rezervë) në serverin AWS në BE. Për Mbledhjen Kryesore të të Dhënave, të dhënat e arritjeve të nxënësve (RM Education Limited) mblidhen dhe ruhen (duke përfshirë kopjet rezervë) në serverin Microsoft Azure në BE.

2) Të dhënat e pyetësorit (IEA) mblidhen dhe ruhen (përfshirë kopjet rezervë) në serverat AWS të vendosur në BE. Serveri IEA SharePoint ku ngarkohen të dhënat WinW3S dhe të dhënat nga instrumentet në letër sipas vendeve, ndodhet në Microsoft brenda BE-së.

Të dhënat e arritjeve ruhen nga RM dhe IEA.

Të gjitha të dhënat që mbërrijnë për përpunim dorëzohen në një formë të koduar, d.m.th., pa emrat e të anketuarve - duke përdorur vetëm një sistem identifikimi ndërkombëtar të rastësishëm.

Me kë dhe si ndahen të dhënat nga TIMSS?

IEA ia nënkontraktton zbatimin ndërkombëtar të TIMSS 2027 Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve me seli në Kolegjin e Bostonit, SHBA, në tekstin në vijim QNS. IEA i ndan të dhënat e anonime me QNS-në nëpërmjet një serveri të sigurt SharePoint. QNS analizon të dhënat e mbledhura të TIMSS 2027 dhe prodhon Raportin Ndërkombëtar. Punonjësit e QNS - së që kanë akses në të dhëna për analiza kanë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti.

IEA ka kryer Vlerësimin e Ndikimit të Transferimit të të Dhënave siç kërkohet për transferimin e të dhënave personale jashtë Zonës Ekonomike Evropiane. IEA mbështetet në klauzolat/faktorët/kushtet Standarde Kontraktuale të KE-së (Moduli II: Nga Kontrollues - Përpunues) për transferimin e të dhënave personale anonime në SHBA.

Qendra Ndërkombëtare e Studimeve ndan të dhënat e koduara me RTI-në për qëllime të përzgjedhjes/kampionimit të shkollave. RTI është një nën-përpunues i autorizuar në SHBA. IEA transferon të dhënat duke përdorur një server të sigurt SharePoint.

Punonjësit e RTI-së që kanë akses/qasje në të dhëna për analiza kanë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti.

IEA ia nënkontraktton administrimin e vlerësimit RM Education Limited (Mbretëria e Bashkuar), degët e së cilës përfshijnë SoNET Systems Pty Ltd (Australi) dhe RM Education Solutions (India) Pvt. Ltd.

Meqenëse RM Education Limited është themeluar në Mbretërinë e Bashkuar, për transferimin e të dhënave personale jashtë Zonës Ekonomike Evropiane, IEA mbështetet në vendimin e Komisionit Evropian mbi mbrojtjen adekuate të të dhënave personale nga Mbretëria e Bashkuar, me anë të të cilit Komisioni Evropian deklaroi se Mbretëria e Bashkuar ofron një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave dhe nuk nevojiten masa të mëtejshme për transferimet e të dhënave. Në rast se qëndrimi i Komisionit Evropian ndryshon në këtë drejtim, pas një Vlerësimi të Ndikimit të Transferimit të të Dhënave, IEA do të lidhë Klauzolat/Faktorët Standarde Kontraktuale të KE-së (Nga Moduli II të Kontrollues- Përpunues) për transferimin e të dhënave personale të koduara në Mbretërinë e Bashkuar.

Akresi/Qasja nga punonjësit e SoNET dhe RM, të cilët veprojnë si përpunues të të dhënave, është e kufizuar në një grup të zgjedhur stafi, të cilëve u kërkohet të kenë akses/qasje për mirëmbajtjen e aplikacionit dhe mjedisit online. Këta punonjës të SoNET dhe RM kanë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti.

IEA gjithashtu ndan të dhënat e koduara me KKK dhe vendet e tjera pjesëmarrëse duke përdorur një server të sigurt SharePoint.

Për TIMSS 2027, QNS në bashkëpunim me IEA do të zbatojë vlerësimin automatik (AS) të bazuar në IA (inteligjencën artificiale) për një nëngrup të ushtrimeve me përgjigje të ndërtuar (CR). Paralelisht me vlerësimin njerëzor të kryer brenda secilit vend/sistem arsimor. Mjeti i bazuar në IA (inteligjencën artificial) për përpunimin e gjuhës ofrohet nga OpenAI, LLC. QNS ka marrë një Shtojcë formale të Përpunimit të të Dhënave në përputhje me GDPR në marrëveshjen e tyre me OpenAI. Kjo është një kontratë që OpenAI nuk do t'i përdorë ose

ruajë të dhënat për trajnim ose përmirësim të modelit. Ajo ofron kushte të qarta për përpunimin, kontrollin e aksesit dhe fshirjen e të dhënave në përputhje me GDPR.

Nën-përpunuesi i OpenAI pajiset vetëm me përgjigje ndaj ushtrimeve CR, pa asnjë informacion personal të identifikueshëm (PII).

Të dhëna të ndërlidhura

Së bashku me nxënësit, mësuesit, drejtorët dhe prindërit, u kërkohet gjithashtu të plotësojnë pyetësorë kontekstual. Informacioni i mbledhur nga të gjitha këto burime është i lidhur, dhe ky informacion i lidhur është në versionin përfundimtar të bazës së të dhënave ndërkombëtare të kërkimit (IDB).

Akresi i publikut/Aksesushmëria publike

Baza e të dhënave përfundimtare ndërkombëtare e kërkimit do të jetë e aksesushme për publikun nga faqet e mëposhtme:

<https://www.iea.nl/data-tools/repository/timss>

<https://timssandpirls.bc.edu/index.html>

Të gjitha të dhënat në bazën e të dhënave janë të koduara dhe, si të tilla, nuk mund të lidhen me individë pa përdorimin e informacionit shtesë, i cili ruhet veçmas, dhe siguria e tij arrihet duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.

Vendimmarrje dhe profilizim i automatizuar

Ne nuk kryejmë asnjë vendimmarrje të automatizuar, përfshirë profilizimin, siç përmendet në Nenin 22 të GDPR-së.

Të drejtat e subjekteve të të dhënave

GDPR ju jep të drejtat e mëposhtme subjekteve të të dhënave:

- E drejta për të tërhequr aprovimin/dakordësimin, nëse përpunimi bazohet në aprovim/dakordësim - Neni 7 i GDPR-së
- E drejta për informim - Nenet 13 dhe 14 të GDPR-së
- E drejta e aksesit - Neni 15 i GDPR-së
- E drejta për korrigjim - Neni 16 i GDPR-së
- E drejta për fshirje - Neni 17 i GDPR-së
- E drejta për kufizim të përpunimit - Neni 18 i GDPR-së
- E drejta për transportueshmëri të të dhënave - Neni 20 i GDPR-së
- E drejta për të kundërshtuar/ankimuar - Neni 21 i GDPR-së
- E drejta për të mos iu nënshtruar vendimeve të bazuara vetëm në vendimmarrjen autorizuar të profilizimit - Neni 22 i GDPR-së
- E drejta për të paraqitur një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës - Neni 77 i GDPR-së